



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes inauguruese të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur më 05.12.2025 në sallën e Kuvendit me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Rasim Hasani, anëtar
2. Daut Azemi , anëtar
3. Shkelzim Olluri, anëtar
4. Nexhmedin Lekiqi, anëtar
5. Hyra Bytyçi, anëtare
6. Murat Gërbeshi, anëtar
7. Fadil Sopa, anëtar
8. Armend Grajçevci, anëtar
9. Fitim Shala, anëtar
10. Venhar Agushi, anëtar
11. Gentianë Hoxhaj- Gashi, anëtare
12. Elmaze Behluli, anëtare
13. Shefki Bytyqi, anëtar
14. Sanije Mehmeti, anëtare
15. Anila Reçica- Llugiqi, anëtare
16. Rinor Murati, anëtar
17. Besim Jusufi, anëtar
18. Feriz Hasani, anëtar
19. Arsim Jashari, anëtar
20. Argjent Tasholli, anëtar
21. Liridon Hajrizi, anëtar
22. Herolind Kozhani, anëtar
23. Egzona Gashi, anëtare
24. Xhenetë Isufi- Mollopolci , anëtare
25. Yllëza Bedrolli, anëtare
26. Agon Bahtiri, anëtar
27. Alban Salihu, anëtar

28. Fatmir Fetahu, anëtar
29. Shahadije Dragaçina, anëtare
30. Valenton Amrllahi, anëtar
31. Arjeta Statovci- Tasholli, anëtare

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës
2. Zenel Tasholli, Kryetar i Gjykatës Themelore në Lipjan
3. Brahim Shatrolli, Komandant i Stacionit Policor në Lipjan
4. Zaim Baftiu, Kryetar i Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan
5. Diamant Bytyqi, Nënkryetar i Komunës
6. Drejtorët e drejtorateve nga mandati i kaluar
7. Përfaqësues të OSBE-së
8. Përfaqësues të OJQ-ve
9. Përfaqësues të mediave dhe
10. Numër i konsideruar i qytetarëve

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Mbledhjen e kryesoi Nexhmedin Lekiqi, i cili tha se mbledhjen e parë e udhëheq anëtari më i vjetër, mirëpo Murat Gërbeshi për arsye personale nuk ka pas mundësi për ta udhëheq radha ka kaluar te unë si i dyti me radhë. Pastaj i përshëndeti të pranishmit në vazhdim, pas konfirmimit nga ana e Sektorit të Kuvendit u konstatua se në mbledhje prezantojnë të gjithë anëtarët e zgjedhur gjithsej 31 dhe se mund të vazhdohet me punë.

Pastaj Kryesuesi tha se për këtë mbledhje është paraparë ky:

REND DITE

1. Dhënia e betimit nga anëtarët e Kuvendit të Komunës
2. Dhënia e betimit të Kryetarit të Komunës
3. Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës

Pastaj u kalua në punë sipas pikës së parë.

I

Dhënia e betimit nga anëtarët e Kuvendit të Komunës

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes, Nexhmedin Lekiqi ftoi anëtarët e zgjedhur të Kuvendit që të ngritën në këmbë dhe të bëjnë betimin duke lexuar deklaratën solemne.

Pastaj anëtarët e Kuvendit duke lexuar deklaratën solemne dhanë betimin.

Shtesë: Deklaratat solemne.

Unë _____, “Betohem (ose deklaroj solemnisht) se do t’i kryej me nder, besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t’i ushtroj autorizimet e mia si anëtar i Kuvendit të Komunës së Lipjanit, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë”.

II

Dhënia e betimit të Kryetarit të Komunës

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes Nexhmedin Lekiqi, ftoi Kryetarin e Komunës z. Imri Ahmetin për dhënien e betimit dhe një fjalë përshëndetëse para anëtarëve të Kuvendit.

Në vazhdim, Kryetari i Komunës z.Imri Ahmeti dha betimin para anëtarëve të Kuvendit duke lexuar deklaratën.

Shtesë: Deklarata solemne.

Unë, Imri Sh Ahmeti, “betohem që do t’i kryej detyrat dhe do t’i ushtrojë kompetencat si Kryetar i Komunës së Lipjanit, me nder, besnikëri, në mënyrë të paanshme, me ndërgjegje dhe në pajtim me ligjin, në mënyrë që t’i siguroj kushte për një jetë të qetë për të gjithë”.

Pastaj Kryesuesi i mbledhjes Nexhmedin Lekiqi ia kaloi fjalën Kryetarit të rizgjedhur të Komunës Imri Ahmeti.

Imri Ahmeti, Kryetari i Komunës i përshëndeti të gjithë të pranishmit në sallë, tha sot jam para juve me emocion dhe me mirënjohje dhe përgjegjësi të madhe pasi që për herë të katërt radhazi më është besuar drejtimi i Komunës së Lipjanit. Ky mandat për mua nuk është privilegj por përgjegjësi, nuk është post politik por amanet qytetar. Është mision për të punuar çdo ditë me përkushtim. Të dashur qytetar, ju falënderoj për mbështetjen dhe që besuat te puna dhe zhvillimi. Ky rezultat është thirrje më shumë për emancipim politik komunikim të qytetëruar dhe fushata dinjitoze. Vizioni ynë është ta ruajmë njerëzoren dhe respektin ndaj njëri-tjetrit. Rezultati në Lipjan është konfirmim i punës së pandërprerë. Sot jep betimin dhe zotohem se do të punoj me transparencë dhe llogaridhënie në çdo fshat, në çdo lagje, në çdo pjesë të qytetit për të gjithë qytetarët pa dallim partie apo bindje. Falënderoj edhe ekzekutivin e deritanishëm,

anëtarët e Kuvendit të mandatit të kaluar dhe të këtij mandati. Po ashtu një falënderim të veçantë e kam edhe për familjen time, familjen Ahmeti pa të cilën ky rrugëtim do të ishte i pamundur. Lipjani do të zhvillohet dhe do të vazhdojmë bashkë rrugën e punës dhe rrugën e rezultateve, rrugën e një Lipjani modern.

Pastaj u kalua në pikën tjetër të rendit të ditës.

III

Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i mbledhjes Nexhmedin Lekiqi, njoftoi Kuvendin se për zgjedhjen e Kryesuesit janë të parapara disa procedura: të zgjidhen dy komisione me nga 3 anëtarë dhe atë:

1. Formimi i komisionit zgjedhor dhe
2. Formimi i komisionit verifikues.

Pastaj Kryesuesi i mbledhjes pyeti anëtarët se a ka propozime për anëtarë të komisionit zgjedhor.

Armend Grajçevci, tha së pari ju uroj mandatin e ri Kryetarit të Komunës dhe të gjithë të zgjedhurve, pastaj tha në emër të grupit të LDK-së për anëtar të komisionit zgjedhor e propozojmë, Rinor Muratin,

Arsim Jashari, tha së pari ju uroj të gjithë të zgjedhurve duke ju uruar suksese dhe punë të mbarë pastaj tha se në emër të grupit të PDK-së për anëtar të komisionit zgjedhor e propozojmë, Argjent Tashollin,

Alban Salihu, tha së pari ju uroj të gjithë të zgjedhurve duke ju uruar punë të mbarë dhe suksese, pastaj tha se në emër të grupit të LVV-së për anëtar të komisionit zgjedhor e propozojmë, Shahadije Bikliqi-Dragaçina.

Pastaj Kryesuesi i mbledhjes Nexhmedin Lekiqi vuri në votim propozimet për anëtarët e komisionit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 31 vota për, aprovoi propozimet për anëtarët e komisionit zgjedhor.

Për komisionin verifikues u propozuan si vijon:

Armend Grajçevci, tha se në emër të grupit të LDK-së, për anëtar të komisionit e propozojmë Gentianë Hoxhaj-Gashi,

Arsim Jashari, tha se në emër të grupit të PDK-së, për anëtar të komisionit e propozojmë Egzona Gashi,

Alban salihu, tha se në emër të grupit të LVV-së, për anëtar të komisionit e propozojmë Arjeta Statovci- Tasholli.

Pastaj Kryesuesi i mbledhjes Nexhmedin Lekiqi vuri në votim propozimet për anëtarët e komisionit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 31 vota për, aprovoi propozimet për anëtarët e komisionit verifikues.

Kryesuesi i mbledhjes Nexhmedin Lekiqi ftoi Komisionin Verifikues që të verifikoj mandatin e anëtarëve.

Më pas njëri nga anëtarët e Komisionit Gentiana Hoxhaj e njoftoi Kryesuesin e mbledhjes se nga ana e komisionit janë verifikuar mandatet në bazë të deklaratave për betim të anëtarëve të Kuvendit të cilët janë gjithsej 31 anëtarë.

Në vazhdim Kryesuesi i Mbledhjes, Nexhmedin Lekiqi pyeti anëtarët e Kuvendit se a ka propozime për Kryesues të Kuvendit?

Fitim Shala, së pari i uroj mandatin Kryetarit Imri Ahmeti, punë të mbarë dhe suksese, po ashtu edhe anëtarëve të Kuvendit ju uroj suksese. Kam nderin në emër të GP të LDK-së propozoi njeriun i cili për dy mandate udhëhoqi Kuvendin në mënyrën më të mirë, po ashtu ishte njeri unifikues për të gjitha grupet në Kuvend, ai është Daut Azemi kandidat për Kryesues të Kuvendit.

Meqë propozime tjera nuk pati për Kryesues të Kuvendit, Nexhmedin Lekiqi kryesuesi i mbledhjes ftoi Komisionin Zgjedhor që të përgatitin listën për votim për Kryesues të Kuvendit.

Komisioni pas përgatitjes së fletëvotimeve, kutisë për votim dhe kabinës për votim, së bashku me Sektorin e Kuvendit treguan se janë bërë të gjitha përgatitjet dhe mund të fillojnë me procedurat e votimit.

Shahadije Bikliqi-Dragaçina, anëtare e komisionit i njoftoi anëtarët e Kuvendit se votimi do të bëhet duke rrumbullaksuar opsionet , a-për apo, b- kundër dhe ftoi me emër anëtarët e Kuvendit për votim sipas listës së Sektorit të Kuvendit.

Pas përfundimit të votimit Kryetari i komisionit Rinor Murati, konstatoi se kanë votuar 31 anëtarë, dhe prej tyre me 16 vota për, 15 vota kundër, Kuvendi zgjedhi Daut Azemin Kryesues të Kuvendit.

Pastaj Kryesuesi i mbledhjes Rinor Murati ftoi kryesuesin e posa zgjedhur të Kuvendit Daut Azemi që ta mbajë një fjalim në Kuvend pastaj për ta udhëhequr mbledhjen të cilit në vazhdim i uroi shëndet dhe punë të mbarë.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit fillimisht i përshëndeti të gjithë të pranishmit në sallë duke ju uruar suksese Kryetarit të Komunës z.Imri Ahmeti, dhe të posa zgjedhurve. Një falënderim i veçantë shkon për Kryetarin e Komunës Imri Ahmetin, grupin e LDK-së dhe strukturat e LDK-së të gjitha strukturat LDK-së. Po ashtu i falënderoj edhe Grupin e LDK-së që më votuan për mandatin e tretë me radhë. Një falënderim shkon edhe për qytetarët e Komunës së Lipjanit të cilët më përkrahën. Për mua është një emocion dhe një ditë e veçantë rizgjedhja për herë të tretë Kryesues i Kuvendit të Komunës së Lipjanit dhe për herë të katërt radhazi anëtar i këtij Kuvendi i cili vjen nga një besim i cili nuk fitohet lehtë, por ndërtohet me punë dhe përgjegjësi dhe

përkushtim. Një falënderim shkon edhe për qytetarët e Komunës së Lipjanit të cilët më përkrahën dhe besuan vizionin tonë.

E falënderoj edhe Kryetarin e Komunës Imri Ahmeti dhe të gjithë ekzekutivin për bashkëpunimin, po ashtu edhe anëtarët e Kuvendit nga mandati i kaluar. Falë punës së mirë sot Lipjani ka ndryshuar për të mirë. Ne si Kuvend duhet të punojmë për të mirën e qytetarëve duke respektuar Rregulloren e Punës së Kuvendit.

Një falënderim e kam edhe për familjen time që më përkrahen që unë të jem këtu.

Pasi çështje të tjera nuk pati mbleldhja përfundoi në ora 11,⁰⁰

Ekstraktin e hartoi

Zyrtari Ligjor
Behar Aliu

Anëtari më i vjetër i Kuvendit
Nexhmedin Lekiqi

Kryesuesi i Kuvendit
Daut Azemi



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA
 REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
 OPŠTINA LIPLJAN
 MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 2-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 18.12.2025, në sallën e Kuvendit, me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Rasim Hasani , anëtar
3. Shkelzim Olluri, anëtar
4. Nexhmedin Lekiqi, anëtar
5. Hyra Bytyçi, anëtare
6. Murat Gërbeshi, anëtar
7. Fadil Sopa, anëtar
8. Armend Grajçevci, anëtar
9. Fitim Shala, anëtar
10. Venhar Agushi, anëtar
11. Gentianë Hoxhaj- Gashi, anëtare
12. Elmaze Behluli, anëtare
13. Shefki Bytyqi, anëtar
14. Saniye Mehmeti, anëtare
15. Anila Reçica- Llugiqi, anëtare
16. Rinor Murati, anëtar
17. Besim Jusufi, anëtar
18. Feriz Hasani, anëtar
19. Arsim Jashari, anëtar
20. Argjent Tasholli, anëtar
21. Liridon Hajrizi, anëtar
22. Herolind Kozhani, anëtar
23. Egzona Gashi, anëtare
24. Xhenetë Isufi- Mollopolci , anëtare
25. Yllëza Bedrolli, anëtare
26. Agon Bahtiri, anëtar
27. Alban Salihu, anëtar
28. Fatmir Fetahu, anëtar
29. Shahadije Bikliqi-Dragaçina, anëtare
30. Valenton Amrllahi, anëtar
31. Arjeta Statovci- Tasholli, anëtare

Të tjerë prezent:

1. Diamant Bytyqi, Nënkryetar i Komunës
2. Latif Ramadani, DBF
3. Shkelzen Hajdini, DSHMS
4. Sead Aliu, DI
5. Valon Pacolli, DEZH
6. Rexhep Rexhepi, DBP
7. Safete Amerllahu, DGJK
8. Burim Rustemi, DSHPMSh
9. Imri Semetishti, DUPMM
10. Përfaqësues të mediave dhe shoqërisë civile dhe të tjerë prezentë

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pasi që i përshëndeti të pranishmit, tha se uroj që jeni mirë, po ashtu tha se ju uroj suksese të zgjedhurve. Pastaj tha se rendin e ditës së bashku me material e keni marrë me kohë, pastaj lexoi rendin e ditës të propozuar:

REND DITE

1. Propozim vendim për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.
2. Propozim vendim për themelimin e Komitetit për Komunitete.
3. Raporti i performancës së komunës së Lipjanit për vitin 2025.
4. Raporti i zbatimit të Planit të Integritetit në Komunën e Lipjanit për periudhën Janar-Dhjetor 2025.
5. Propozim Vendim për anulimin e Vendimit 15NR.462/01-27002 të datës 29.05.2025 për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit 1NR.464-47684 të datës 29.09.2015 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës në ZK-Babush i Muhaxherëve.
6. Propozim Vendim për miratimin e Planit orientues të punës së Kuvendit të Komunës së Lipjanit për vitin 2026.
7. Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Lipjanit për vitin 2024 dhe Plani i zbatimit të rekomandimeve të auditorit të pranuar me raportin final nga Auditori i Zyrës Kombëtare të Kosovës për vitin 2024, të cilin auditim e ka kryer Zyra Kombëtare e Auditimit.
8. Raporti vjetor i NJAB-së për vitin 2024.

Pastaj Kryesuesi pyeti a ka vërejte apo plotësime rreth rendit të ditës?

Armend Grajqevci, pasi që i përshëndeti të pranishmit dhe ju uroj punë të mbarë dhe suksese të po sa zgjedhurve tha se, kam një kërkesë, që çështjet e pyetjeve dhe përgjigjeve të kalohen në fund të rendit të ditës. Për arsye që të ua japin rëndësinë

apo fokusin pikave të rendit të ditës, pasi që rëndësia e rendit të ditës po zbehet pas diskutimeve të shumta dhe nuk po e merr fokusin e duhur. Po ashtu kemi edhe një kërkesë për iniciimin e ndryshim plotësimit të Rregullores së Punës së Kuvendit.

Arsim Jashari, tha se së pari ju uroj suksese të gjithëve na shkoftë puna mbarë e mirë. Unë nuk pajtohem me parafolësin pasi që të gjitha kërkesat dhe propozimet vijnë prej qytetarëve, ne jemi këtu për qytetarët dhe mund të jemi më të shkurtër në pyetje dhe është më e arsyeshme që pyetjet të bëhen në fillim. Dhe nuk mendoj që pyetjet e zbehin rëndësinë e pikave të rendit të ditës.

Shahadije Bikliqi-Dragaçina, tha se ju uroj suksese të gjithë anëtarëve të Kuvendit duke ju dëshiruar punë të mbarë, ne si grup i LVV mendojmë se duhet të vazhdojmë me praktikën e mëhershme pasi që ka qenë një praktikë më e mirë dhe nuk mendoj që e zbehin rëndësinë e pikave të rendit të ditës pasi që ne këtu jemi për qytetarët dhe duhet të diskutohet për problemet dhe hallet e qytetarëve. Ne jemi kundër që të ndryshohet kjo.

Armend Grajçevci, tha se unë nuk thashë që nuk do të diskutohen çështjet por vetëm të shtyhen në fund të rendit të ditës, por për arsye që të ju jepet më shumë fokus rendit të ditës pa dashtë me i zbeh kërkesat dhe interesimet që kanë të bëjnë me qytetarët, kërkesa jonë si grup është që të shtyhet në fund të rendit të ditës.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, tha se shumë shpejt do të vij në Kuvend plotësim ndryshimi i Rregullores së Punës së Kuvendit dhe këtë çështje do ta vendosim në fund të rendit të ditës ashtu siç e kanë komunat e tjera. Jemi duke e shikuar procedurën se si do të jetë përbërja e komisionit.

Pastaj Kryesuesi e hodhi në votim propozimin e grupit të LDK-së që të jetë në fund pyetjet dhe çështjet e anëtarëve të Kuvendit. Pas votimit u konstatua se me 16 vota për, dhe 14 kundër, u aprovua propozimi i grupit të LDK-së.

Arsim Jashari, tha se në propozim të kolegut ishin dy kërkesa, duhet me i nda çështja e pyetjeve për fund dhe ndryshimi dhe plotësimi i rregullores.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, tha se ne e votuam vetëm propozimin për pyetje ndërsa për rregulloren për ndryshim plotësim do të vazhdojmë në mbledhjet e ardhshme pas konsultimit edhe me zyrën ligjore.

Pastaj Kryesuesi e hodhi në votim rendin e ditës dhe pas votimit u konstatua se me 30 vota për, u aprovua rendi i ditës.

I

Propozim vendim për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi, Daut Azemi, i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin.

Armend Grajçevci, tha se ne si grupi i LDK-së i kemi tri propozime për anëtarë të KPF-së duke e respektuar kuotën gjinore dhe ata janë: Armend Grajçevci, Anila Reçica- Llugini, Elmaze Behluli.

Argjent Tasholli, tha se ne si grup i PDK-së për anëtarë të KPF-së e propozojmë: Arsim Jashari dhe Egzona Gashi.

Valenton Amrllahu, tha se ne si grup i LVV-së për anëtarë të KPF-së e propozojmë: Alban Salihu.

Daut Azemi, tha se përbërja e Komitetit për Politikë dhe Financa është

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Armend Grajçevci, anëtar i Kuvendit nga LDK
3. Anila Reçica- Llugini, anëtare e Kuvendit nga LDK
4. Elmaze Behluli, anëtare e Kuvendit nga LDK
5. Arsim Jashari, anëtar i Kuvendit nga PDK
6. Egzona Gashi, anëtare e Kuvendit nga PDK
7. Alban Salihu anëtar i Kuvendit nga LVV

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 30 vota për, aprovoi propozimin

II

Propozim vendim për themelimin e Komitetit për Komunitete

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Armend Grajçevci, tha se ne si grupi i LDK-së i kemi tri propozime për anëtarë të Komitetit për Komunitete: Fitim Shala, Gentianë Hoxhaj-Gashi, Hyra Bytyçi.

Xheneta Isufi Mollopolci, tha se ne si grup i PDK-së për anëtarë të Komitetit për Komunitete propozojmë: Yllëza Bedrolli.

Alban Salihu, tha se ne si grup i LVV-së për anëtarë të Komitetit për Komunitete e propozojmë: Shahadije Bikliqi-Dragaçina.

Daut Azemi, tha se përbërja e Komitetit për Komunitete është si në vijim:

1. Fitim Shala, anëtar i Kuvendit - LDK
2. Gentianë Hoxhaj-Gashi anëtare e Kuvendit - LDK
3. Hyra Bytyçi, anëtare e Kuvendit - LDK
4. Yllëza Bedrolli, anëtare e Kuvendit - PDK
5. Shahadije Bikliqi-Dragaçina ,anëtare e Kuvendit - LVV
6. Fehmi Rexhepi, Komuniteti Ashkali
7. Maksut Gashi, Komuniteti Rom
8. Slavisa Trajkovic, Komuniteti Serb
9. Alush Bikliqi, Komuniteti Turk
10. Zoran Cirkovic, Komuniteti Malazez
11. Olga Gucic, Komuniteti Kroat

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 30 vota për, aprovoi propozimin.

III

Raporti i performancës së komunës së Lipjanit për vitin 2025

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Shemsi Azemit, koordinator i performancës, i cili, në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin.

Arsim Jashari, tha se ne kemi pranuar raportin e performancës dhe i kam krahasuar edhe me vitet e kaluara. Ne si Kuvend kemi obligim ligjor që ky raport të jetë sa më i saktë dhe i vërtetë siç e kërkojnë ligjet në fuqi, por fatkeqësisht ky raport nuk është ashtu, pasi që nëse e krahason me vitet e kaluara shumë indikator përsëriten, përqindjet mbesin të njëjta dhe narrativi nuk ndryshon. Ky raport më shumë është raport formal sesa që ka një analizë, ka përqindje që nuk përputhet me realitetin p.sh ka përqindje të madhe te konsultimet publike, këshillat lokale, mjedisi, barazia në punë dhe arsimi ndërsa realiteti është ndryshe, kur e dimë që te konsultimet publike shumicën e rasteve salla mbushet me zyrtarë të Komunës sesa me qytetarë, gjithashtu edhe këshillat lokale nuk është që funksionojnë. Sa i përket mjedisit Komuna e Lipjanit është kampion për deponi ilegale. Te arsimi ka shpesh anulim të konkurseve, punësime pa meritë e çështje tjera. Humbja e grantit të performancës është arsyetim jo bindës pasi që kontrata kolektive ka qenë në fuqi edhe në vitin 2022-2023 dhe në ato vite Komuna ka fituar grant dhe ky arsyetim është jo bindës. Ky raport nuk pasqyron realitetin por arsyeton dështimet dhe dezinformon Kuvendin.

Shahadije Bikliqi-Dragaçina, tha se kur e sheh këtë raport është për tu çuditur se si është bërë vlerësimi në shumë fusha me arritje 100%, sipas meje si qytetare këto të dhëna nuk janë reale kur dihet se dallimi mes asaj që keni shkruar në letër dhe realiteti janë shumë i madh. Kur e shikon te ambienti ka vlerësim të lartë e realiteti është krejt ndryshe kur dihet se si është gjendja me mbeturina në Komunën tonë. Po ashtu edhe për kulturën është shënuar arritje 100%, a ne në Lipjan nuk kemi as Qendër të Kulturës, njëjtë është gjendja edhe të dëgjimet publike ku marrin pjesë vetëm disa qytetar. Nuk është më e mirë gjendja as në Këshillet Lokale, ku ka Këshill që nuk ka mbajt kurrë asnjë takim. Në raport është shënuar diçka ndërsa realiteti është diçka tjetër.

Shemsi Azemi, tha se raporti i performancës përbëhet prej 13 zyrtarë, ku secili zyrtar merr informata nga drejtoratet e caktuara e të cilat informata janë të kontrolluara nga MAPL dhe DEMOS-i. Çdo tregues i vendosur e ka edhe dokumentin e ngarkuar. Këto dokumente vijnë shabllon dhe mund t'i gjeni edhe në faqen e MAPL-së. Dhe arsyeja pse jemi eliminuar nga performanca është kontrata kolektive.

Armend Grajçevci, tha se unë së pari i falënderoj zyrtarët e komunës të cilët kanë bërë një punë të jashtëzakonshme duke nxjerr rezultate të sakta. Sfidë kryesore ka qenë kontrata kolektive ne të gjithë e dimë, jo veç e komunës tonë por edhe shumë komunave tjera dhe problemet që i ka shfaqë kjo kontratë. Komuna e Lipjanit që disa

vite e ka fituar grantin e përformancës por këtë vit për shkak të kontratave kolektive s'e fiton.

Arsim Jashari, tha se së pari është mirë me pas kushte të punës pasi që salla është shumë e ftoftë dhe nuk po ka kushte për të punuar. Askush nuk e kontestoj që shërbimet e administratës nuk janë 100% por unë i kam nxjerr disa pika ku ato nuk janë reale me raportin që ju e prezantoni. Ato të dhëna zyrtarët i marrin nga drejtoratet e caktuara por nuk do me thënë që ato janë reale. Kontrata kolektive nëse humb në shkallën e parë lënden, pse po shkoni në shkallën e dytë po bëni shpenzime?

Shemsi Azemi, tha se viteve të kaluara ka qenë kontrata kolektive por nuk e ka kaluar limitin, ndërsa në vitin 2024 e ka kaluar kufirin.

Daut Azemi, tha se te titulli duhet të jetë për vitin 2024 jo 2025.

Meqë diskutime nuk pati, u kalua në pikën në vazhdim.

IV

Raporti i zbatimit të Planit të Integritetit në Komunën e Lipjanit për periudhën Janar-Dhjetor 2025

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Valon Pacollit, drejtor i DEZH, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin.

Arsim Jashari, tha se raporti tregon disa indikator si të realizuar por kjo nuk e pasqyron realitetin . Unë i kam nxjerr disa probleme të cilat i kanë publikuar edhe KDI-ja dhe GAP-i. Web faqet komunale shpesh nuk janë të strukturuar mirë dokumentet nuk gjenden lehte, dokumentet në gjuhën zyrtare mungojnë. Kërkesat tona për këtë raport janë indikatorë që mbasin rezultate reale jo vetëm publikim teknik. Një raport që i tregon edhe dobësitë jo vetëm arritjet.

Shahadije Dragaçina-Bikliqi, tha se në hyrje të këtij raporti te objektivat e planit thuhet ka qenë një komision, por unë kam një pyetje ky komision a ka shikuar mirë të gjitha ndërtimet si bëhen.

Valon Pacolli, tha se ky raport është hartuar prej një komisioni prej 11 anëtarëve përfshirë secilën drejtori, ky raport do të shkoj në agjencinë për anti korrupsion dhe aty çdo gjë vërtetohet nga agjencia.

Arsim Jashari, tha se është normale që behet prej zyrtarëve bëhet komisioni prej secilës drejtori por nuk mund të themi që i japin të dhënat e sakta.

Valon Pacolli, tha se çdo dokument që paraqitet në raport kërkohet edhe dëshmia e paraqitur.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin.

Meqë diskutime nuk pati u kalua në pikën në vazhdim.

V

Propozim Vendim për anulimin e Vendimit 15NR.462/01-27002 të datës 29.05.2025 për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit 1NR.464-47684 të datës 29.09.2015 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës në ZK-Babush i Muhaxherëve

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Valon Pacollit drejtor i DEZH, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin.

Arsim Jashari, tha se ne PDK-ja, kemi votuar atëherë pro këtij propozimi edhe pse ju kemi thënë që nuk e përmbush ligjshmërinë. Por për hirë të sportit dhe KF Gadimja do të votojmë prapë për.

Shahadije Dragaçina-Bikliqi, tha se ne për shkak të pa qartësive ligjore që është kthyer nga MAPL, ne do të abstenojmë.

Argjent Tasholli, tha se sa i përket këtij propozimi edhe e tha shefi i grupit, por unë si përfaqësues i Gadimes i ftoj edhe anëtarët e LVV-së që mos të abstenojnë por të votojnë për të mirën e vendit tonë. Ju ftoj që të na bashkoheni dhe të bëjmë për të mirën e Gadimes.

Armend Grajçevci, tha se ne grupi i LDK-së, e mbështesim këtë pikë pasi që kemi qenë edhe iniciues të këtij propozimi dhe shpresojmë që do të zgjidhen këto paqartësi dhe bëhet një zgjidhje për këta banorë.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, tha se vendimi është kthyer jashtë afateve ligjore nga ana e MAPL-së. Ligjërisht vendimi do të duhej me hy në fuqi, por ne e kemi pruar në kuvend dhe është mirë me anuluar.

Shahadije Bikliqi, tha se pas sqarimit nga ana juaj edhe ne do të votojmë për.

Arsim Jashari, tha se nëse e shikojmë arsyetimin e ministrisë, ata nuk e kanë kundërshtuar ndarjen e pronës por vetëm ndarjen e parcelave.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 30 vota për, aprovoi propozimin.

VI

Propozim Vendim për miratimin e Planit orientues të punës së Kuvendit të Komunës së Lipjanit për vitin 2026

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Valon Pacollit, drejtor i DEZH, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin.

Argjent Tasholli, tha se sa i përket këtij plani parashihet që të mbahen rreth 12 mbledhje brenda vitit siç i parash Ligji për Vetëqeverisje Lokale. Unë e kam një propozim që edhe seancat solemne të jenë si seanca të veçanta e jo si vendimmarrëse, siç është 17 shkurti Dita e Pavarësisë dhe 12 qershori Dita e Çlirimit për arsye se do e lehtësonte punën e Sektorit të Kuvendit dhe ne anëtarët do ta kemi ne plan të punës. Edhe pse ligji nuk na detyron.

Shahadije Bikliqi- Dragaçina, tha se në plan të punës e kemi mbledhje edhe në muajin gusht, ne nuk kemi mbajtë në muajin gusht mbledhje.

Daut Azemi, tha se ka raste kur edhe kemi mbajtë mbledhje në muajin gusht. Ky është plan orientues nuk është fiktiv dhe nuk kisha thënë me ndryshuar.

Armend Grajqevci, tha është një plan i mirë i punës, ku ceket që duhet të mbahen 12 mbledhje në vit. Në nenin 4. 3 ceket që Kuvendi mund të mbaje mbledhje të rregullta, jashtëzakonshme dhe urgjente edhe seancat solemne janë të përfshira. Një plan i punës që e kemi mbështetë edhe në të kaluarën dhe do ta mbështesim edhe këtë vit.

Arsim Jashari, tha se e kemi pas një propozim të përbashkët për një vizite zyrtare si anëtarë të Kuvendit, ne duhet të dalim jashtë politikës pasi që këtu i përfaqësojmë qytetarët dhe mund të jemi kolegë shumë të mirë dhe do të ishte shumë e rëndësishme ta bënim një vizite zyrtare jashtë vendit sidomos për kolegët e rijsë dhe me pa se si funksionojnë kuvendet tjera.

Argjent Tasholli, unë nuk e thash që e parasheh ligji që mbledhjet solemne të jenë pjesë e planit, por ne me e lehtësuar punën e kuvendit, me 17 shkurt duhet të jetë obligim moral për mbajtjen e një mbledhje solemne.

Daut Azemi, tha se është e precizuar në nenin 4 të ligjit rreth mbledhjeve shumë mirë, unë kisha hedh në votim si është tani duke e përfshirë edhe propozimin për një vizitë jashtë shtetit.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 30 vota për, aprovoi propozimin.

VII

Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Lipjanit për vitin 2024 dhe Plani i zbatimit të rekomandimeve të auditorit të pranuar me raportin final nga Auditori i Zyrës Kombëtare të Kosovës për vitin 2024, të cilin auditim e ka kryer Zyra Kombëtare e Auditimit

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Safet Krasniqit, Auditor i Brendshëm, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin.

Arsim Jashari, tha se në publikimin e këtij raporti nga zyra e auditimit, Komuna e Lipjanit e ka marr opinionin të kualifikuar në vend të opinionit të pastër apo të pakualifikuar. Kjo do të thotë se ekzistojnë mos përputhje në mes të raportit financiar dhe përdorimit të fondeve publike. Ky opinion është konstatim i shkeljeve reale ku ka pas shkelje materiale të regjistrimit të shpenzimeve, duke përfshirë pagat jubilarë, ushqime, mallra dhe shërbime. Komuna ka regjistruar një shumë të madhe të kapitalit të dyfishtë. Këto gabime nuk janë teknike e të vogla. Ka pas shkelje edhe në prokurim ku auditori ka gjet shkelje se procesi i prokurimit ka qenë i mangët ku ka pas vendosje të emrave në dosje të tenderëve dhe kanë bërë diskriminim. Po ashtu edhe pagesa jo të arsyeshme. Po ashtu ka gjet si shkelje pagesën e vonuar të detyrimeve duke e rrezikuar rentabilitetin financiar të komunës. Rekomandimet nuk janë zbatuar me

kohe ose pjesërisht. Raporti i auditorit nuk është dokument formal pa ndikim ai gjen gabime dhe shkelje konkrete. Si kuvend duhet të kërkojmë plan konkret të zbatimit dhe masa disiplinore për zyrtarët përgjegjës.

Shahadije Bikliqi-Dragaçina, tha së pari ky raport vjen me disa muaj vonesë dhe kjo nuk është në rregull. Por si raport ka nxjerr në pah keq menaxhimin dhe gjetje të tjera. Gjetjet kryesore të këtij raporti janë keq klasifikimi i shpenzimeve, pasaktësi në pasqyrimin e aseteve komunale, mangësi në menaxhimin e kontratave publike dhe dobësi në bazën e të dhënave për taksapaguesit e pronës. Vonesa në pagesa të detyrimeve dhe shume shkelje tjera. Këto të gjetura janë shumë shqetësuese.

Armend Grajqevci, tha se unë mendoj që është një transparencë sjellja e raportit të auditorit ne kuvend pasi që po e shohim në detaje të gjithë anëtarët e Kuvendit. Ky raport i përmban katër pika. E para opinionin e auditorit, gjetjet dhe rekomandimet, informacioni i përmbledhur dhe progresi në zbatimin e rekomandimeve. Si shqetësim mbetet edhe këtu kontrata kolektive por ne si komunë mendoj që ja kemi dal mirë nëse i shikojmë komunat tjera. Dhe si komunë e kemi kaluar mirë. Te gjetjet e auditorit ekzekutivi duhet ti zbatoj dhe si raport është i saktë dhe presim që vitet tjera do të na gjejnë në zbatim të këtyre rekomandimeve.

Safet Krasniqi, tha se dua të jap një sqarim nga një e gjetur janë bërë disa rekomandime, pagesat të cilat po tërhiqen nga përmblyesit janë si rezultat i kontratës kolektive dhe këto po ndikojnë në vonesa të pagesave, në keq klasifikim. Ka pas disa gabime teknike edhe nga auditori të shifrave. Ku të programi i tatimit në pronë kanë qenë disa të meta.

Arsim Jashari, tha se po pajtohem për mos me u pajtuar, po e them këtë pasi që katër vite e kemi diskutuar punën e kontratës kolektive. Po ti a e din që 4 vite sa lëndë i keni në shkallë të dytë që i keni kundërshtuar vendimet, po grumbullohen lëndët edhe tani po mirren shume mjete.

Daut Azemi, në bazë të informacioneve që i kam komuna e ka obligim me u ankimuar deri në shkallën e fundit. Raporti nuk është vonuar por ne kemi qenë në fushatë dhe kanë qenë edhe disa procedura tjera.

Meqë diskutime tjera nuk pati u kalua në pikën në vazhdim.

VIII

Raporti vjetor i NJAB-së për vitin 2024

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Safet Krasniqit, i cili, në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin.

Arsim Jashari, tha se unë i kam nxjerr disa rekomandime por kam disa pyetje. Çka keni ndërmarrë ju që me mujt me u evidentuar këto probleme, vendimet për emërimet e drejtorëve komunal nuk janë regjistruar në librin e protokollit. Rekomandimi A8 mos harmonizimi i kontratave të punës dhe akteve të emërimit nga 78 mostra në 46 raste niveli i pagës nuk ka qenë i saktë sipas koeficientit ligjor. Çfarë rekomandimi keni bërë për këtë pasi që kemi të bëjmë me shkelje të të drejtave të punëtorëve. Është mirë afatet ligjore me u respektuar pasi që ne jemi në vitin 2026 gati e po e diskutojmë raportin për vitin 2024.

Safet Krasniqi, tha se na s'kemi bërë ende rekomandime, por pritet të bëjmë me emërimin e drejtorëve të ri. Te dallimi mes koeficienteve të pagave me listën e kontratave për shkak të numrit të madh të punëtorëve në arsim DKA, ka thënë që do të ndërrohet koeficienti në fund të vitit për shkak të numrit të madh të punëtorëve. Secila drejtori për te gjeturat e veta ka obligim që ta përmirësoj të gjeturën.

Pastaj u kalua në

Pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

Arsim Jashari, tha të nderuar qytetarë sot nuk po e hapin një mandat të ri por një kapitull të ri me përgjegjësi dhe besim ndaj jush. Ne nuk jemi këtu për fjalë boshe por për juve. Si grup i PDK-së, me një ekipe profesioniste një ekipë që i njeh nga afër nevojat e qytetarëve të Komunës së Lipjanit dhe do të jemi këtu për interesin e të gjithë qytetarëve. I nderuar kryesues kam një pyetje buxheti i komunës ka pas me ardhur me 30 shtator dhe deri me tani nuk ka ardhë ku është, pse nuk ka ardhë në afatet ligjore. Cili është problemi pasi që ne po hyjmë në vitin 2026 dhe ne nuk kemi asnjë informatë se çka po ndodh me buxhetin. Kam një propozim për ty si kryesues dhe për Sektorin e Kuvendit, për anëtarët e Kuvendit që kanë dhënë kontribut për dy e më shumë mandate të ju ndahet një mirënjohje për punën që kanë bërë në kuvend. Në fund i falënderoj ish kolegët e legjislaturës 2021-2025 të cilët kanë bërë një punë të jashtëzakonshme.

Shahadije Bikliqi-Dragaçina, tha se kam një pyetje pse ende nuk janë emëruar drejtorët e komunës pasi që ka kaluar 2 muaj nga zgjedhjet. E dyta ndriçimi publik në disa lagje të Lipjanit nuk ka funksionuar, kryesisht në lagje kah xhamia, a është rregulluar deri tani ndriçimi publik në atë pjesë.

Argjent Tasholli, tha se unë për 4 vite kam qenë kryetar i këshillit të prindërve në shkollën “Zenel Hajdini” në Gadime , dhe kërkesë solide e prindërve të cilët i qojnë fëmijët në këtë shkollë është që të jetë një autobus që i plotëson kushtet për bartjen e atyre nxënësve pasi që autobusi që është tani është i vogël dhe nuk i plotëson kushtet.

Daut Azemi, tha se çështja e buxhetit nuk ka ardhur për shkak se kemi qenë në zgjedhje dhe shumica e komunave nuk e kane bërë, tani shpejt do të vijë në kuvend por e kemi lënë që të themelojmë dhe KPF-në që ta diskutojmë edhe aty. Çështja e mirënjohjeve për anëtarët e Kuvendit mundemi me diskutuar për ndonjë seancë solemne apo të ngjashme në të ardhmen me i shpërndarë. Ekzekutivi është punë e kryetarit kur i emëron drejtorët.

Diamant Bytyqi, Nënkryetar i Komunës, tha se së pari ju uroj për mandatin e ri ty Kryesues dhe të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Çështja e buxhetit nuk e ka shty vetëm Komuna e Lipjanit por shumë komuna, ka qenë kërkesë edhe e Asociacionit të Komunave që të shtyhet mos të votohet gjatë fushatës së zgjedhjeve. Zgjedhja e ekzekutivit është punë e Kryetarit. Ndriçimi publik është funksionalizuar kontrata dhe aty ku ka prishje do te rregullohet ndriçimi.

Pasi çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 12:15.

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA
 REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
 OPŠTINA LIPLJAN
 MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 3-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 09.01.2026, në sallën e Kuvendit, me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Rasim Hasani , anëtar
3. Shkelzim Olluri, anëtar
4. Nexhmedin Lekiqi, anëtar
5. Hyra Bytyçi, anëtare
6. Murat Gërbeshi, anëtar
7. Fadil Sopa, anëtar
8. Armend Grajçevci, anëtar
9. Fitim Shala, anëtar
10. Venhar Agushi, anëtar
11. Gentianë Hoxhaj - Gashi, anëtare
12. Elmaze Behluli, anëtare
13. Shefki Bytyqi, anëtar
14. Sanije Mehmeti, anëtare
15. Anila Reçica- Llugiqi, anëtare
16. Rinor Murati, anëtar
17. Besim Jusufi, anëtar
18. Feriz Hasani, anëtar
19. Arsim Jashari, anëtar
20. Argjent Tasholli, anëtar
21. Liridon Hajrizi, anëtar
22. Herolind Kozhani, anëtar
23. Egzona Gashi, anëtare
24. Xhenetë Isufi- Mollopolci , anëtare
25. Yllëza Bedrolli, anëtare
26. Agon Bahtiri, anëtar
27. Alban Salihu, anëtar
28. Fatmir Fetahu, anëtar
29. Shahadije Bikliqi-Dragaçina, anëtare
30. Valenton Amrllahi, anëtar
31. Arjeta Statovci- Tasholli, anëtare

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës
2. Diamant Bytyqi, Nënkyetar i Komunës
3. Latif Ramadani, DBF
4. Shkelzen Hajdini, DSHMS
5. Sead Aliu, DI
6. Valon Pacolli, DEZH
7. Safete Amerllahu, DGJK
8. Imri Semetishti, DUPMM
9. Përfaqësues të mediave dhe shoqërisë civile dhe të tjerë prezentë

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pasi që i përshëndeti të pranishmit, tha se rendin e ditës së bashku me material e keni marrë me kohë, pastaj lexoi rendin e ditës të propozuar:

REND DITE

1. Propozim Vendim mbi aprovimin e Buxhetit për vitet 2026-2028.

Pastaj Kryesuesi pyeti a ka vërejte apo plotësime rreth rendit të ditës?

Arsim Jashari, tha se ka qenë mirë me na ardh procesverbali i mbledhjeve të kaluara të kuvendit, pasi që kjo nuk është mbledhje e jashtëzakonshme por e rregullt. Dhe e dyta, pse nuk kemi pyetje parlamentare pasi që është mbledhje e rregullt e kuvendit dhe sipas Rregullores së Punës së Kuvendit është dashtë me pas edhe pyetje parlamentare.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, tha se sa i përket procesverbalit po e jap një sqarim ka qenë festë dhe punëtoret kanë qenë në pushime, por në mbledhjen e ardhshme do ti keni të gjitha bashkë. Ka ndodh edhe në të kaluarën që nga 2 a 3 procesverbale nuk janë ardhë.

Shahadije Bikliqi-Dragaçina, tha se pse nuk ka pyetje të anëtarëve të Kuvendit këtë mbledhje është e pa kuptueshme, pasi që kjo është mbledhje e rregullt.

Daut Azemi, tha se nga mbledhja e ardhshme do të ketë edhe pyetje të anëtarëve të Kuvendit, pasi që këtë mbledhje është diskutim për votimin e buxhetit dhe nuk e kemi thirrë të jashtëzakonshme me arsyen që me ju dhanë hapësirë edhe juve më shumë për me shqyrtuar.

Pastaj Kryesuesi e hodhi në votim rendin e ditës dhe pas votimit u konstatua se me 20 vota për, 1 kundër dhe 4 abstenime, u aprovua rendi i ditës.

Propozim Vendim mbi aprovimin e Buxhetit për vitet 2026-2028

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Latif Ramadanit, drejtor i DBF i cili, në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, tha se një përmirësim të vogël se me paska ikë, me njoftuan nga Sektori i Kuvendit, në votim të rendit të ditës kane qenë 26 vota për, 1 kundër dhe 4 abstenime për shkak të procesverbalit të përmirësohet.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin.

Armend Grajqevci, tha se e falënderoj drejtorin për elaborimin e kësaj pike, sa i përket kësaj pike një ndër projektet që e shoh me prioritet pasi edhe vet vij nga ai region është vazhdimi i ndërtimit të ujësjellësit për fshatrat Ribar i Madh, Kraishtë, Zllakuqan, Hallaq, Bujan dhe fshatrat tjera, një projekt që ka mbet në gjysmë qe sa vite por tani është paraparë që brenda vitin 2026 të përfundohet. Po ashtu ky buxhet ka gjithëpërfshirje për të gjitha fshatrat dhe qytetin e Lipjanit. Si dhe disa sektor janë me theks të veçantë siç janë Kulturë, Rini, Sport, Shëndetësi dhe Arsim. Po ashtu edhe te tabelat digjitale ku Komuna e Lipjanit është ndër komunat e para për digjitalizimin e arsimit një projekt me interes. Ka edhe projekte të tjera, Ne grupi i LDK-së, e përkrahim këtë buxhet.

Arsim Jashari, tha së pari propozim vendimi për buxhetin është i vonuar pasi që afati i fundit ka qenë 30 shtatori por e keni shfrytëzuar edhe ju këtë vakumin e mungesës së institucioneve të nivelit qendror e shfrytëzojnë të gjithë. Ne po flasim për një buxhet jo për çështje të shifrave por çështje dinjiteti, transparence dhe përgjegjësi ndaj qytetarëve. Ne e dimë që në ditët e fundit të zgjedhjeve lokale janë shpërndarë pa kriter, pa plan dhe për interesa të ngushta politike paratë publike. Dhe sot po na ofrohet ta votojmë një propozim buxhet i cili për mendimin tonë nuk është për qytetarët, por për interesa të ngushta për shpërndarje selektive dhe mbrojtjen e imazhit personal. Brenda këtij buxheti kemi një problem të veçantë, projektet e pa identifikuar të rrugëve, ku më shumë se 10 kode buxhetore asfaltimi i rrugëve dhe rrugicave nuk specifikohet emërtimi i tyre. Dhe kjo na jep mundësinë e keqpërdorimit të buxhetit në baza partiake. Ky nuk është një gabim teknik por është bërë qëllimisht për favore dhe privilegje të caktuara. Po ashtu në këtë buxhet figurojnë projektet që nga viti 2021 për vitin 2027 siç janë renovimi i shkollës në Banullë dhe Dobrajë. Ky nuk është zhvillim por mashtrim me qytetarët. Po ashtu në këtë buxhet nuk janë paraparë të realizoni disa premtime të kryetarit nga të cilat morët besimin e

qytetarëve, si ndërtimi i stacionit të ri të autobusëve, ndërtimi i nënkalimit që e lidh qytetin me pjesën tjetër të hekurudhës dhe subvencioni për lehonat ose të po sa lindurit. Ajo çka është ma e rëndësishmja brenda këtij buxheti janë futur edhe dy vendime për UÇK-në, faza e dytë në fshatin Krojmir 62 mijë euro dhe projekti për fshatin Shalë afër 95 mijë euro. Qëndrimi jonë si PDK është i qartë nxirrni këto dy vendime veçmas dhe ne i votojmë sot te dyja vendimet, por nuk mundeni me thënë për këto dy vendime që nuk e votuan një buxhet që është selektiv i një anshëm dhe ka qëllime të këqija. Edhe një herë po e them, nxirrni këto dy vendime veçmas ne PDK-ja, i votojmë. Për ndryshe ne nuk kemi votë për këtë buxhet.

Shahadije Bikliqi-Dragaqina, tha se sa i përket propozim vendimit mbi aprovimin e Buxhetit për vitet 2026-2028, mendoj që ky buxhet nuk është i duhuri dhe ai që do të duhej të ishte. Për neve grupin e LVV, ky buxhet nuk është i orientuar dhe ndarë në mënyrën e drejtë, pasi që ka keq menaxhim dhe gabim të orientuar të mjeteve. Nëse e krahason buxhetin e këtij viti me atë të vitit 2024 të cilin e ka votuar ky Kuvend shqetësimet janë evidente ku ka pas ndryshime të cilat ndryshe janë planifikuar e ndryshe planifikohen tani. Ka disa projekte që janë planifikuar për vitin 2026 atëherë por tani nuk figurojnë, si asfaltimi i rrugicave në fshatrat Gllogovc dhe Konjuh. Ndërtimi i rrugës Teqe - Shushicë, ndërtimi i rrugës në Hanrovc të gjitha janë planifikuar në vitin 2024 dhe janë shtyrë deri ne vitin 2026 dhe shumë projekte të tjera që janë shtyrë në vitin 2027 dhe me këtë po mashtrohen qytetarët e Komunës së Lipjanit. Tjetra që është shumë shqetësuese te investimet kapitale është ndërtimi i parkut të qytetit dhe parkingu nëntokësor, me sa e dimë ne ky është planifikuar të përfundoj në vitin 2025 ky projekt, ndërsa planifikohet edhe gjysmë milion euro për këtë projekt e njëjta është edhe për Qendrën Urgjente në Lipjan. Po ashtu ka shumë projekte të cilat janë planifikuar për këtë vit si në shëndetësi, arsim, kulturë , por janë shtyrë për vitet në vazhdim. Ky buxhet nuk është në rregull dhe nuk i plotëson nevojat e qytetarëve dhe ne si grup i LVV-së, nuk e mbështesim këtë buxhet.

Arjeta Statovci- Tasholli, tha se sa i përket propozim buxhetit, me sa e kam vërejtur unë në 3 vitet e ardhshme, nuk ka ndarje të mjeteve për çështje gjinore është zero. Po ashtu nuk ka mjete të ndara edhe ne fushën e emergjencave. Unë e kam një propozim që të shtohet një shumë e mjeteve te çështjet sociale, të ndahen 50 mije euro për çështjet gjinore nga kodi buxhetor i zyrës se kryetarit nga linja e subvencioneve. Si dhe 50 mije euro për menaxhimin e emergjencave dhe 20 mije euro për çështje sociale ku duhet të përfshihen pagesat për fëmijët pa kujdesje prindërore, viktimat e dhunës, dhe sigurim të banimit për gratë viktimat të dhunës. Kërkoj nga ana juaj kryesues që këto propozime të hyjnë në buxhet dhe të votohen pasi që behet fjalë për

një fushë shumë të ndjeshme të cilat kërkojnë trajtim të veçantë dhe përgjegjësi institucionale .

Alban Salihu, tha se qëndrimet tona i dhanë dy koleget, por unë dua me ngrit një anomali të cilën e kam hasë, në vitin 2021 Kryetari i Komunës ka premtuar që deri në vitin 2022 kanë me u asfaltuar të gjitha rrugicat në Komunën e Lipjanit. Ndërsa sot ndahen mbi 1 milion euro për asfaltimin e këtyre rrugicave, përgjigjja mund të jetë se janë krijuar rrugica për shkak të ndërtimit të shtëpive, por nuk besoj që ka pas ndërtim të shtëpive aq shumë, sa me u nda mbi 1 milion euro për shtrimin e rrugicave. Ka qenë një premtim i pa realizuar. Unë këtë buxhet e kisha përkufizuar si buxhet për pagesa të kryera ndaj këtij pushteti për zgjedhje lokale.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, tha se ka pas një kontrate të lidhur për zhavorrim dhe asfaltim të rrugicave sepse askush nuk shtron asfalt pa pas një kontratë. Ka qenë një kontratë dy vjeçare.

Alban Salihu, tha pse nuk cekën me emër rrugët dhe rrugicat të cilat do të asfaltohen apo rregullohen.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, tha ka pas një kontrate dy vjeçare ku janë kryer asfaltimi i atyre rrugicave do të vazhdohen edhe këtë vit disa që kanë mbet.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, tha së pari ju uroj punë të mbarë dhe suksese Nënkrjetarit të Komunës dhe juve të tjerëve. Unë do të përgjigjem në disa pyetje të cilat janë në interes të publikut. Buxheti jo vetëm në nivel vendi por në të gjitha komunat ka progres dhe ky progres është linearisht në vitet që vijnë i bazuar në buxhetin në nivel vendi, e përcaktuar në baze të tavaneve buxhetore nga Qeveria. Pjesa dërmuese e këtij buxheti është te pagat dhe mëditjet. Ajo që komunës tonë i duhet në vitet e ardhshme është shtimi i mjeteve në kategorinë e mallrave , kategorinë e subvencioneve. Ndërsa komunalit kanë shënuar rritje për shkak të rritjes së çmimeve të energjisë elektrike, çmimet e shpenzimeve të ujit dhe komunalive që çdo ditë po shënojnë rritje. Ndihe mirë që Komuna e Lipjanit çdo vit po shënon një rritje të mirë të të hyrave vetanake dhe është një tregues i stabilitetit buxhetor. Vitin e ardhshëm janë mbi 3 milion euro të hyra vetanake. Ju tani në këtë buxhet nuk e shihni bartjen e të hyrave vetanake. Ne edhe me pas aprovuar buxhetin më herët ka qenë e kot se ska pas institucione. Ne presim që të ketë rritje të buxhetit për këtë vit pas bartjes së të hyrave dhe tejkalimit të të hyrave mbi 1.4 milion euro të cilat e kemi për obligim ti procedojmë në kuvend për tu aprovuar. Jo të gjitha kemi mujt me i akomoduar në këtë buxhet pavarësisht nevojave që i kemi në teren, është përpjekje me i prioritarizuar ato

që mendojmë që janë më me prioritetet për vitin e parë të punës të këtij mandati. Nuk ka ndarje të re të mjeteve buxhetore por është bartje e mjeteve prej vitit të kaluar në këtë vit siç është rasti te nënkalimi, emergjenca e disa projekte tjera. Rrugicat, çdo mbledhje ka kërkesa nga ana juaj të asfaltohet ajo rrugice, ose rrugica tjetër. Ideja jonë është që të bëhet asfaltimi i rrugicave në çdo familje dhe është e pa drejtë të ndërpritet kjo aty ku nuk kemi probleme pronësore. Buxheti nuk mund të ndahet me dy e tri projekte, o votohet në tërësi o nuk aprovohet si tërësi. Tendanca për ti ndarë dy projekte është vetëm tendencë e mos votimit ajo është çështje e vendimmarrjes politike të secilit subjekt politik. Por nuk ka buxhet që mund të ndahet për një projekt të veçantë. Pati kërkesa për kode të reja buxhetore, kodet buxhetore nuk i ndërtojnë komunat. Ligji nuk ua jep këtë të drejtë komunave, por nivelit qendror. Ndihamat për kategoritë të ndryshme janë disa te drejtoritë e disa te zyra kryetarit. Unë e bartë përgjegjësinë për atë që e kam premtuar për qytetarët e komunës së Lipjanit dhe do ti realizoj. Viti që jemi do të jetë vit sfidues për shkak të detyrimeve kontingjente, kemi të bëjmë me pagesat e kontratave kolektive për pasojat që po i vuajnë komunat. Kërkoj nga ana juaj që të aprovoni këtë propozim vendim.

Pastaj Kryesuesi e hodhi në votim dhe pas votimit u konstatua se me 16 vota për, 15 kundër, u aprovua propozimi për aprovimin e buxhetit.

SHTOJCË:

VENDIM

MBI APROVIMIN E BUXHETIT PËR VITET 2026-2028

Neni 1.

Me këtë Vendim aprovohet Buxheti për vitet 2026-2028 për Komunën e Lipjanit.

Neni 2.

Buxheti për vitet 2026-2028 do të financohet:

FONDI BURIMOR	VITI 2026	VITI 2027	VITI 2028
Grant i Përgjithshëm	11,218,401.00	12,082,527.00	13,051,829.00
Grant Specifik i Arsimit	9,965,184.00	10,264,140.00	10,572,064.00
Grant Specifik i Shëndetësisë	3,012,734.00	3,103,116.00	3,196,210.00
Të hyrat vetanake	3,368,140.00	3,618,802.00	3,634,463.00

Financimi Sherbimet Rezedenciale	200,000.00	200,000.00	230,000.00
TOTALI	27,764,459.00	29,268,585.00	30,684,566.00

Neni 3.

Mjetet nga neni 2.i këtij Vendimi do shpërdahen në kategorit ekonomike si vijon:

KATEGORITE EKONOMIKE	VITI 2026	VITI 2027	VITI 2028
Paga e Mëditje	14,592,317.00	14,665,279.00	14,738,605.00
Mallra dhe Shërbime	4,119,119.00	4,395,000.00	4,565,000.00
Shërbime Komunale(Komunalit)	527,000.00	527,000.00	527,000.00
Subvencione dhe Transfere	1,290,000.00	1,817,000.00	1,852,000.00
Investimet Kapitale	7,236,024.00	7,864,305.00	9,001,960.00
TOTALI	27,764,460.00	29,268,584.00	30,684,565.00

Neni 4.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi pas publikimit në Web faqen e Komunës dhe tabelën e shpalljeve.

Neni 6.

Me këtë Vendim të njoftohet Drejtorati për Buxhet dhe Financa, ndërsa një kopje ruhet në materialin e Kuvendit.

Pasi çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 11:05.

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Zyrtari Ligjor

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi